

L I G J
Nr.8564, datë 22.12.1999

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJEVE "PËR PROGRAMIN E HARMONIZIMIT DHE
TË INTEGRIMIT TË KONTROLLIT TË TRAFIKUT AJROR EUROPIAN (EATCHIP)"
DHE "PËR ZBATIMIN E MASAVE TË MENAXHIMIT TË DREJTIMIT TË TRAFIKUT
AJROR NGA NJËSIA E MENAXHIMIT QENDROR TË DREJTIMIT TË FLUKSIT
(CFMU)" NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS EUROPIANE
PËR SIGURINË E NAVIGIMIT AJROR (EUROCONTROL)**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohen marrëveshjet "Për programin e harmonizimit dhe të integrimit të kontrollit të trafikut ajror evropian (EATCHIP)" dhe "Për zbatimin e masave të menaxhimit të drejtimit të trafikut ajror nga njësia e menaxhimit qendror të drejtimit të fluksit (CFMU)" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (Eurocontrol).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.250, datë 17.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE
**DYPALËSHE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS EUROPIANE
PËR SIGURINË E NAVIGIMIT AJROR, LIDHUR ME PROGRAMIN EUROPIAN TË
MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR (EATMP)**

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, këtej e tutje e quajtur si "Shteti", dhe Organizata Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (Eurocontrol) e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie, këtej e tutje e quajtur si "Organizata";

Duke marrë në konsideratë Konventën Ndërkombëtare lidhur me Bashkëpunimin për Sigurinë në Navigimin ajror, ndryshuar në Bruksel në vitin 1981, këtej e tutje e quajtur si "Konventë e Ndryshuar dhe në veçanti nenin 2.1, 7.2 dhe 11.3 të saj;

Duke marrë në konsideratë ftesën e bërë nga Ministrat e Transportit të Shteteve Anëtare të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC) më 24 prill 1990 për Agjencinë që të drejtojë Programin e Harmonizimit dhe Integrimit të Kontrollit të Trafikut Ajror Evropian, këtej e tutje e quajtur si "EATCHIP", në partneritet me Administratat Kombëtare të Shteteve anëtare të ECAC-ut;

Duke marrë në konsideratë direktivën nr.46 të Komisionit të Përhershëm të 14 gushtit 1990, që i besoi Agjencisë drejtimin e EATCHIP-it, në partneritet me Administratat Kombëtare të Shteteve anëtare të ECAC-ut, në kuadrin e Bordit të Projektit të EATCHIP-it, i cili u zëvendësua nga Grupi konsultativ i Drejtimit të Trafikut Ajror ATM/CNS, këtej e tutje i quajtur si "ACG";

Duke marrë në konsideratë vendimin e 9 dhjetorit 1997 të Komisionit të Përhershëm nr.71 në implementimin e disa kushteve në Konventën e Ndryshuar, veçanërisht lidhur me rolin dhe detyrat e Organizatës nr.72 në implementimin e disa kushteve të Konventës së ndryshuar, veçanërisht me

krijimin e Këshillin Paraprak dhe nr.73, që miratoi modifikimet e aneksit 1 të Konventës së Ndryshuar lidhur me statusin e Agjencisë;

Duke marrë në konsideratë vendimin nr.77/1 të Komisionit të Përhershëm të 14 gushtit 1990 që autorizon Agjencinë për të nisur bisedimet dhe për të përfunduar Marrëveshjet me Shtetet e ECAC-ut, të cilët nuk janë anëtarë të EUROCONTROL-it lidhur me programin EATCHIP;

Duke marrë në konsideratë evoluimin e EATCHIP-it nëpërmjet Programit European të Menaxhimit të Trafikut Ajror, këtej e tutje i quajtur "EATMP";

Ranë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë i beson Organizatës në bashkëpunim me Administratat Kombëtare të Shteteve anëtare të ECAC-ut dhe në kuadrin e "ACG", drejtimin e Programit European të Menaxhimit të Trafikut Ajror, "EATMP" për ta aplikuar në sistemet e saj të Drejtimit të Trafikut Ajror.

Neni 2

Republika e Shqipërisë do të bëjë rregullimet e nevojshme të legjislationit të saj për të garantuar që zhvillimi i saj kombëtar, programet e projektimit dhe investimet janë bërë në përputhje me të gjitha vendimet ose masat e marra nga "ACG" dhe/ose Organizata, në rolin e saj si agjent drejtues i EATMP-it.

Neni 3

Në vazhdim të parashikimeve të nenit 2, Republika e Shqipërisë do të implementojë çdo standard të EUROCONTROL-it të firmosur nga "ACG" dhe do të marrë të gjitha masat e kërkuara për të vepruar në përputhje me Programin e Konvergimit dhe Implementimit.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të kontribuojë për stafin që lidhet me EATMP-in, shpenzimet e operimit dhe investimet që bëhen nga Agjencia. Kontributi financiar i pagueshëm nga Republika e Shqipërisë do të llogaritet sipas formulës për ndarjen e pjesës së dhënë në Aneks, i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

a. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk është zgjidhur me mirëkuptim, do t'i referohet Arbitrazhit me kërkesën e secilës nga Palët.

b. Për këtë qëllim, secila nga Palët në çdo rast do të caktojë një arbitër dhe arbitrat do të bien dakord për caktimin e një arbitri të tretë. Në rast se njëra nga palët nuk do të caktojë arbitrin e saj brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës nga pala tjetër, ose në rast se arbitrat e caktuar nuk do të bien dakord që brenda këtyre dy muajve të caktojnë arbitrin e tretë, secila palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare (International Court of Justice) të bëjë caktimin e arbitrit.

c. Arbitrazhi do të caktojë vetë procedurat e tij.

d. Secila palë do të përballojë shpenzimet e arbitrit të saj dhe përfaqësimin në procedurat përpara gjyqit. Shpenzimet e arbitrit të tretë dhe shpenzimet e tjera do të përballohen në mënyrë të barabartë nga Palët në konflikt. Sidoqoftë Arbitrazhi mund të vendosë një ndarje tjetër të shpenzimeve në rast se ai e shikon të arsyeshme.

e. Vendimi i arbitrazhit do të jetë i detyrueshëm për Palët në konflikt.

Neni 6

Në rastet e gjendjes së emergjencës ose luftës, kjo Marrëveshje mund të pezullohet me vendim

të përbashkët të Palëve ose me një njoftim të njëanshëm me shkrim nga njëra Palë për Palën tjetër.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur Republika e Shqipërisë do të lajmërojë Organizatën Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL), për plotësimin e obligimeve kushtetuese në lidhje me përfundimin dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë me një njoftim me shkrim 3 muaj përpara nga njëra Palë për Palën tjetër.

Bërë në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe, frënge dhe në gjuhën angleze, të tre tekstet janë të barazvlefshme. Në rast diskutimi teksti në anglisht është prioritar.

Firmosur në Bruksel, më 8 korrik 1999.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I.Shuli

Ministër i Punëve Publike
dhe Transportit

PËR ORGANIZATËN EUROCONTROL

Y.Lambert

Drejtor i Përgjithshëm

MARRËVESHJE

DYPALËSHE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS EUROPIANE PËR SIGURINË E NAVIGIMIT AJROR, LIDHUR ME IMPLEMENTIMIN E MASAVE TË MENAXHIMIT TË DREJTIMIT TË FLUKSIT TË TRAFIKUT AJROR NGA NJËSIA E MENAXHIMIT QENDROR TË DREJTIMIT TË FLUKSIT (CFMU)

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, këtej e tutje i quajtur "Shteti", dhe Organizata Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL), përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie, këtej e tutje e quajtur "Organizatë";

Duke marrë në konsideratë Konventën Ndërkombëtare lidhur me Bashkëpunimin për Sigurinë në Navigacionin Ajror, ndryshuar në Bruksel në vitin 1981, këtej e tutje e quajtur si "Konventë e ndryshuar" dhe në veçanti nenin 2.1.k. që i jep të drejtën Organizatës për t'i asistuar Shteteve jo anëtare të interesuara në krijimin dhe operimin e një sistemi ndërkombëtar të menaxhimit të drejtimit të fluksit të trafikut ajror;

Duke marrë në konsideratë vendimin e Ministrave të Transportit të Shteteve Anëtare të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC) më 20 tetor 1988, për t'i besuar Organizatës krijimin e një sistemi të vetëm të centralizuar të menaxhimit të Drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror në Europën Perëndimore;

Duke marrë në konsideratë vendimin e marrë nga Komisioni i Përhershëm në Sesionin e tij të 75-të, më 4 korrik 1989 për të krijuar një Njësi Qendrore të Menaxhimit të Drejtimit të fluksit (CFMU), që do të ekzekutojë masat e menaxhimit të Drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror për të gjithë rajonin që i takon shteteve anëtare të ECAC-ut dhe veçanërisht planin e miratuar të implementimit të CFMU;

Duke marrë në konsideratë nenin 11 të Konventës së ndryshuar dhe të vendimit nr.79/10 të Komisionit të Përhershëm të datë 3 dhjetor 1991, që i delegon Agjencisë autoritetin për të lidhur marrëveshje dypalëshe të nevojshme për implementimin e masave të Menaxhimit të Drejtimit të fluksit të Trafikut Ajror të marra nga CFMU;

Duke marrë në konsideratë vendimin e 9 dhjetorit 1997 të Komisionit të Përhershëm nr.71 në implementimin e disa kushteve të Konventës së ndryshuar, veçanërisht lidhur me rolin dhe detyrat e Organizatës nr.72 në implementimin e disa kushteve të Konventës së ndryshuar, veçanërisht në krijimin e një Këshilli Provizor dhe nr.73 që miraton modifikimet e Aneksit 1 të Konventës së ndryshuar lidhur me statusin e Agjencisë;

Duke marrë në konsideratë që masat e Menaxhimit të Drejtimit të fluksit të trafikut Ajror janë gjithashtu për të garantuar një drejtim të sigurt dhe të rregullt të trafikut ajror brenda hapësirës ajrore të shteteve joanëtare, veçanërisht të Republikës së Shqipërisë;

Ranë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë e ngarkon Organizatën me sigurimin e një shërbimi të vetëm ndërkombëtar të Menaxhimit të Drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror për hapësirën ajrore të saj, ose në hapësirën ajrore në lidhje me të cilën i janë besuar rregullat e sigurimit të shërbimeve të trafikut ajror nga marrëveshje ndërkombëtare, këtej e tutje e quajtur "Hapësira Ajrore e Shtetit".

Republika e Shqipërisë, sipas kërkesës, do t'i japë Organizatës informacionin që mund të kërkohej për të përcaktuar shtrirjen e hapësirës ajrore të Shtetit.

Neni 2

Organizata do të bëjë përgatitjet e nevojshme për të siguruar zbatimin e rregullave e procedurave të saj, planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e masave të Menaxhimit të Drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror në hapësirën ajrore të Shtetit.

Neni 3

Shteti do të bëjë rregullimet e nevojshme të legjislacionit të tij për të siguruar zbatim të rregullt të masave për Menaxhimin e drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror të Organizatës në bashkëpunim me sistemin ndërkombëtar të menaxhimit të drejtimit të fluksit të trafikut ajror të krijuar nga Organizata.

Neni 4

Atje ku do të bihet dakord ndërmjet palëve për dhënien e shërbimeve specifike të menaxhimit të drejtimit të fluksit ajror nga Organizata brenda hapësirës ajrore të shtetit, këto marrëveshje do të bëhen me shkrim.

Neni 5

Organet kompetente të Organizatës mund të vendosin për futjen e pagesës së kontributit financiar për shtetet joanëtare për dhënien nga Organizata të Shërbimeve të Menaxhimit të Drejtimit të Fluksit të Trafikut Ajror.

Atje ku Palët bien dakord për kushtet e këtij kontributi financiar që do të bëhet nga Republika e Shqipërisë, kushtet konkrete do të përcaktohen me një marrëveshje bilaterale me shkrim.

Neni 6

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk është zgjidhur me mirëkuptim, do t'i referohet Arbitrazhit me kërkesën e çdo njëres nga Palët.

2. Për këtë qëllim, secila nga Palët në çdo rast do të caktojë një arbitër dhe arbitrat do të bien dakord për caktimin e një arbitri të tretë. Në rast se njëra nga palët nuk do të caktojë arbitrin e saj brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës nga pala tjetër ose në rast se arbitrat e caktuar nuk do të bien dakord që brenda këtyre dy muajve të caktojnë arbitrin e tretë, secila palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të bëjë caktimin e arbitrit.

3. Arbitrazhi do të caktojë vetë procedurat e tij.

4. Secila Palë do të përballojë shpenzimet e arbitrit të saj dhe përfaqësimin në procedurat përpara gjyqit. Shpenzimet e arbitrit të tretë dhe shpenzimet e tjera do të përballohen në mënyrë të barabartë nga Palët në konflikt. Sidoqoftë Arbitrazhi mund të vendosë një ndarje tjetër të shpenzimeve në rast se ai e shikon të arsyeshme.

5. Vendimi i arbitrazhit do të jetë i detyrueshëm për Palët në konflikt.

Neni 7

Në rastet e gjendjes së emergjencës ose luftës, kjo Marrëveshje mund të anulohet me vendim të përbashkët të Palëve ose me një njoftim të njëanshëm me shkrim nga njëra Palë për Palën tjetër.

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur Republika e Shqipërisë do të lajmërojë Organizatën Europiane për sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL) për ratifikimin e saj.

Në rast se Republika e Shqipërisë pranohet në Konventën e Ndryshuar, Marrëveshja do të bjerë automatikisht nga fuqi në ditën efektive të pranimit.

Bërë në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe, frënge dhe në gjuhën angleze, të tre tekstet janë të barasvlefshme. Në rast diskutimi teksti në anglisht është prioritar.

Firmosur në Bruksel, më 8 korrik 1999.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I.Shuli

Ministër i Punëve Publike

dhe Transportit

PËR ORGANIZATËN EUROCONTROL

Y.Lambert

Drejtor i Përgjithshëm

ANKES

KONTRIBUTI FINANCIAR VJETOR I PAGUESHËM NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËR ORGANIZATËN LIDHUR ME PROGRAMIN EUROPIAN TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR

Neni 1

1. Kontributi vjetor financiar i pagueshëm nga shteti për Organizatën, lidhur me Programin e Harmonizimit dhe Integritetit të Kontrollit të Trafikut Ajror European (EATMP), do të llogaritet mbi bazën e formulës së ndarjes si më poshtë:

a) 30 për qind e kontributit fillestar do të llogaritet në proporcion me vlerën e Prodhimit Kombëtar Bruto (GDP) të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në paragrafin 2 më poshtë:

b) diferenca prej 70 për qind e kontributit do të llogaritet në proporcion me vlerën e kosto bazë të pajisjeve të navigimit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në paragrafin 3 më poshtë.

2. Prodhimi Kombëtar Bruto (GDP) që do të përdoret për llogaritje do të merret nga statistikatat e hartuara nga Organizata për Kooperimin dhe Zhvillimin Ekonomik ose në pamundësi të kësaj nga një organizëm tjetër që ofron garanci të njëjta dhe të caktuara sipas një vendimi të Komisionit të Përhershëm - duke llogaritur mesataren aritmetike për tre vjetët e fundit për të cilat ekzistojnë të dhënat statistikore. Vlera e GDP do të jetë ajo e llogaritur mbi bazën e faktorit kosto dhe çmimeve aktuale të shprehura në Njësinë Monetare Europiane.

3. Kosto bazë e mjeteve të navigimit që do të përdoren për llogaritje do të jetë kosto bazë e vendosur në vitin e fundit, por përpara vitit financiar në vazhdim.

Neni 2

Formula e mësipërme e ndarjes do të aplikohet për:

1. të gjithë koston e stafit, operimit dhe investimeve të EATMP për buxhetin e vitit në vazhdim;

2. koston shtesë të Agjencisë e fiksuar në masën 15 për qind të koston sipas pikës 1 më sipër.

Neni 3

Fondet do t'i paguhen Organizatës, me kërkesën e kësaj të fundit, katër herë në vit në proporcionin e 4/12 përpara 20 janarit, 3/12 përpara 12 prillit, 3/12 përpara 15 korrikut dhe 2/12 përpara 15 tetorit.

Kontributi do të faturohet dhe paguhet në EURO në llogarinë bankare të Organizatës.

ANEKS

MARRËVESHJE LIDHUR ME FINANCIMIN E MASAVE PËR MENAXHIMIN E DREJTIMIT TË FLUKSIT TË TRAFIKUT AJROR NGA NJËSIA QENDRORE E MENAXHIMIT TË DREJTIMIT TË FLUKSIT (CFMU)

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, këtej e tutje e quajtur "Shteti",

Dhe

Organizata Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL) e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie, këtej e tutje e quajtur "Organizatë";

Duke marrë në konsideratë Konventën Ndërkombëtare lidhur me kooperimin për Sigurinë e Navigimit Ajror, ndryshuar në Bruksel në vitin 1981 dhe veçanërisht nenet e saj 11 dhe 12;

Duke marrë në konsideratë masat nr.79/10 të Komisionit të Përhershëm, të datës 3 dhjetor 1991, që i delegon Agjencisë autoritetin për të lidhur marrëveshje dypalëshe të nevojshme për implementimin e masave të Menaxhimit të Drejtimit të fluksit të Trafikut Ajror të marra nga CFMU;

Duke marrë në konsideratë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror lidhur me implementimin e masave të Menaxhimit të Drejtimit të fluksit të Trafikut Ajror të marra nga Njësia Qendrore e Menaxhimit të Drejtimit të Fluksit (CFMU) dhe në veçanti nenin 5 që parashikon firmosjen e një marrëveshjeje bilaterale me shkrim për kontributin financiar të shtetit;

Ranë dakord sa më poshtë:

Neni 1

1. Kontributi vjetor financiar i pagueshëm nga Republika e Shqipërisë për Organizatën, lidhur me masat e marra nga CFMU për Menaxhimin e Drejtimit të Trafikut të Fluksit Ajror, do të llogariten mbi bazën e formulës së ndarjes si më poshtë:

a) 30 për qind e kontributit fillestar do të llogaritet në proporcion me vlerën e Prodhimit Kombëtar Bruto (GDP) të Shtetit, siç përcaktohet në paragrafin 2 më poshtë;

b) diferenca prej 70 për qind e kontributit do të llogaritet në proporcion me vlerën e koston bazë të pajisjeve të navigimit të shtetit, siç përcaktohet në paragrafin 3 më poshtë.

2. Prodhimi Kombëtar Bruto (GDP) që do të përdoret për llogaritje do të merret nga statistikën e hartuara nga Organizata për Kooperimin dhe Zhvillimin Ekonomik - ose në pamundësi të kësaj nga një organizëm tjetër që ofron garanci të njëjta dhe të caktuara sipas një vendimi të komisionit - duke llogaritur mesataren aritmetike për tre vjetët e fundit për cilat ekzistojnë të dhënat statistikore. Vlera e GDP-së do të jetë ajo e llogaritur mbi bazën e faktorit kosto dhe çmimeve aktuale të shprehura në euro.

3. Kosto bazë e mjeteve të navigimit që do të përdoren për llogaritje do të jetë kosto bazë e vendosur në vitin e fundit, por përpara vitit financiar në vazhdim.

Neni 2

Formula e mësipërme e ndarjes do të aplikohet për:

1. të gjithë koston e stafit, të operimit dhe investimeve të CFMU-së për buxhetin e vitit në vazhdim;

2. për koston shtesë të Agjencisë, e fiksuar në masën 12 për qind të koston sipas pikës 1 më sipër.

Neni 3

Në analogji me procedurën e pagesës së kontributeve nga Shtetet Anëtare, fondet do t'i paguhet Organizatës, me kërkesën e kësaj të fundit, katër herë në vit në proporcionin e 4/12 përpara 20 janarit, 3/12 përpara 15 prillit, 3/12 përpara 15 korrikut dhe 2/12 përpara 15 tetorit.

Kontributi do të faturohet dhe paguhet në euro në llogarinë bankare të Organizatës.

Neni 4

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur Republika e Shqipërisë do të lajmërojë Organizatën Europiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL), për plotësimin e obligimeve kushtetuese në lidhje me përfundimin dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ajo do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e Marrëveshjes përkatëse Dypalëshe për implementimin e masave të Menaxhimit të Fluksit të trafikut ajror nga CFMU.

Bërë në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe, frënge dhe në gjuhën angleze, të tre tekstet janë të barazvlefshme. Në rast diskutimi teksti në anglisht është prioritar.

Firmosur në Bruksel, më 8 korrik 1999.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I.Shuli

Ministër i Punëve Publike
dhe Transportit

PËR ORGANIZATËN EUROCONTROL

Y.Lambert

Drejtor i Përgjithshëm